



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më  
2.11.2023, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja (NISMA), Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Fehmi Kupina (i pavarur).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare, Alban Zogaj, nënkryetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Osman Bllaca dhe përfaqësues të medieeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, i cili tha se para se të fillojmë me mbledhjen do ta kujtojmë datën historike të 2 nëntorit me shënimin e 34 vjetorit të rënjes së heronjve të kombit Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Po ashtu e kujtojmë edhe datën e 3 nëntorit me rastin e përvjetorit të vdekjes së veprimtarit të shquar kombëtar akademikut Anton Qeta, andaj ju lus të ngritemi në këmbë në shenjë respekti dhe nderimi për heronjtë tonë.

**Kryesuesi** hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Valbona Makolli**, drjetore kërkoi që pika e dhjetë e rendit të ditës: Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare OJQ-së "Defy Them Community", në vlerë prej 5000 e, të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se ato mjete janë ndarë me thirrjen e fundit nga Drejtoria e Kulturës.

**Jeta Rafuna**, propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01-020/07-257562/22, dt. 25.11.2022.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, hiqet nga rendi i ditës pika e dhjetë: Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare OJQ-së "Defy Them Community".**

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 1 abstenim, hyn në rend të ditës për diskutim pika: Propozim-vendimin për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01-020/07-257562/22, dt. 25.11.2022.**

**Kryesuesi konstatoi se me ndryshime dhe plotësime, më 27 vota për, u miratua ky**

#### **Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3);**
- 3. Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01-020/07-257562/22, dt. 25.11.2022;**
- 4. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria një histori në harta";**

5. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës;
6. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës, për vitin shkollor 2023/2024;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Children's new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina's Schools";
8. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Gjithçka rreth IV";
9. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare "Vrapo Babadimër";
10. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e konferencës "Growzillas L.L.C";
11. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Pallati i Rinisë", SHA;
12. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Sport Marketing";
13. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit "Ec me mua";
14. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet;
15. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Lakërishta", për bllokun "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8" në Prishtinë;
16. Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023;
17. Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ-së "Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës";
18. Pyetje dhe përgjigje;
19. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit.

#### Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2023 (TM3).

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli drejtore e cila tha se ky raport është i përgatitur me dispozitat e nenint 45 paragrafi 45.2 dhe 4 dhe 46 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiive. Raporti i përgatitur nga kabineti i kryetarit, përkatësisht nga Drejtopria e Financave e mbulon këtë tremujor të vitit fiskal dhe paraqet informatat për arkëtimet apo të hyrat vetanake dhe shpenzimet e dhëna të cilat kërkojnë sipa këtij ligji.

**Mirsad Vitia** tha se buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2023 është afërsisht 158 milion euro, nga ky buxhet për periudhën janar –shtator 2023 Komuna e jonë ka shpenzuar rreth 68 milion euro apo 43% të buxhetit dmth për nëntë muaj nuk është shpenzuar as gjysma e buxhetit të këtij viti, përfshirë këtu edhe dy projekte me marveshje më të mdha si menaxhimi i mbeturinave dhe shpenzimet e transportit publik më afër 4.5 milion euro. Nga të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore për këta nëntë muaj, përqindjen më të lartë të realizimit të buxhetit e ka kategoria e pagave dhe mëditjeve me 89% dhe më të ultën kategoria e shpenzimeve kapitale me një përqindje prej 20%.

Për ta kuptuar më mirë punën e drejtorive komunale duhet ti shohim shpenzimet e tyre në projektet kapitale dhe si shembull konkret mund ta marrim Drejtorinë e Investimeve Kpitale dhe Menaxhimikt të Kontratave. Nga 76 projekte të planifikuara në 44 prej tyre janë shpenzuar mjete dhe në 32 sosh nuk është investuar asgjë për nëntë muaj, pra po flasim për projekte si ndërtimi i shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, ndërtimi i varrezave të dëshmorëve në Viti të Marecit, ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën “Agim Ramadani”, ndërtimi i platformës ndërlidhëse në mes lagjes “Arbëria” dhe Pallati i Rinisë, etj si dhe shumë projekte tjera të infrastrukurore jetike për qytetarët e Prishtinës, e të citat mbase do të shtyhen për vitin tjetër. Si përfundim prej 44 milion buxhet për këto 76 projekte, kësaj drejtorie i teprojnë afër 41 milion euro dhe në këtë periudhë korrik –shtator ajo shënon progres vetëm 11% të realizimit të tyre.

**Sami Salihu** tha se ky raport është përgatitur në përputhje me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1, të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe gjatë këtij tre mujori të ardhurat e Komunës kanë shënuar një rritje të ndjeshme duke arritur 23.75% të buxhetit vjetor, pra një rritje prej 25.12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rritje është përgjithësisht e lidhur me rritjen e taksave, veçanërisht taksën mbi pronën, tarifave të inspektimit, të ardhurave nga infrastruktura dhe tarifave për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

Në këtë tre mujorë kemi një rritje prej 41.77% të shpenzimeve krahasuar me vitin e mëparshëm, ku kjo rritje është në përgjithësi e lidhur me shpenzimet e larta në mallra dhe shërbime si dhe investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë 18% të buxhetit të përgjithshëm. Sa i përket shpenzimeve kapitale ato kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 6 milion e 869 mijë e 450.48 euro krahasuar me vitin e mëparshëm.

**Leutrim Retkoceri** tha se në këtë raport janë të evidentuara të gjitha shifrat se sa qëndron realizimi i buxhetit të vitit 2023. Për realizimin e projekteve në investimet kapitale, koha e cila ka mbetë, shpresoj që të shfrytëzohet në realizimin sa më të shpejtë të projekteve të parapara në mënyrë që realizimi i buxhetit të ngritë shifra të kënaqshme si për ekzekutivin, po ashtu edhe për Kuvendin e Kryeqytetit. Vlen të theksohet që ka disa projekte të parapara

nga ekzekutivi apo në drejtori të cilat nuk janë të filluara ende dhe pres që në një seancë tjetër të kemi një raport të këtyre projekteve se çfarë ka ndodhur me to dhe pse nuk kanë filluar të zbatohen.

**Gëzim Mehmeti**, për raportin financiar paraqiti disa vërejtje, me ç'rast tha se e dhe përkundër asaj që vërejtjet i kam dorëzuar me shkrim në mënyrë zyrtare, ato nuk janë marra parasysh, kështu që ky raport në esencë ka gabime në përmbajtje dhe në shifra. Te kodi buxhetor 48038, mbetja në fund duhet të jetë 463 euro e jo 513 euro do të thot se mungojnë më se 100.000 euro.

Kolektori te rruga "A", të shpenzuara në TM 3, 900 mijë e 4 55101 euro, pra mbetja duhet me qenë 4 milion e 105 mijë euro, e jo 5 milion euro, kështu që 1 milion euro nuk dihet se ku janë. Po ashtu në kodin buxhetor 52573 është ndërtimi i rrugës "Antigona Fazilu", "Mbreti Bardhyl", ku janë të shpenzuara mbi 350 mijë euro dhe prap aty figuron mbetje prej 350 mijë euro që do të thot se nuk është shfrytëzuar asnjë para, pastaj përqindjet janë të gjitha gabim, kështu që në këtë raport ka edhe gabime të tjera që duhet të përmirësohen.

**Nora Kelmendi**, fillimisht shprehu shqetësim lidhur me realizimin e ulët të të hyrave komunale si dhe buxhetit për investime kapitale për TM3 dhe për vitin 2023 për Komunën e Prishtinës.

Nëse i shikojmë shpenzimet e drejtorive komunale mund të konstatojmë se gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur shpenzime kapitale, kështu që shumë projekte të planifikuara me një përqindje të vogël janë realizuar. Nga kjo shihet se rënja e shpenzimeve kapitale të buxhetit po dëshmon një paaftësi të madhe pasi që i keni planifikuar projektet kapitale mirëpo nuk po i kryeni brenda vitit. Ju bëjë thirrje që të bëni një analizë më të hollësishme të arsyeve të mos shpenzimit të buxhetit, të ndërmerri masat e nevojshme për përmirësimin e proceseve të punës.

**Faton Zeka**, me diskutimin e tij kryesisht u fokusuar tek Sektori i bujqësisë i cili tha se disa nga projektet e planifikuara rreth kësaj fushe nuk janë realizuar, si shembull konkret mori thertoren publike, projekt i cili është përfshirë në raportin TM3, vetëm sa për ta përmbushur një rubrikë të raportit, mirëpo nuk është bërë asnjë hap përpara në realizimin e tij. Po ashtu

ndërtimi i tregut mobil në Sheshin "Zahir Pajaziti", ku ai treg vepron me ato qoshqe që janë në gjendje jo të mirë. Pse janë futur në raport këto projekte kur nuk është bërë asnjë hap drejt realizimit të tyre.

**Feim Osmani** tha se sa i përket këtij raporti shqetësim kryesor është shpenzimi i pa kriter, shpenzimi i pa arsyeshem, shpenzimi i cili nuk sqarohet mjaftueshem, kështu që struktura dhe mënyra se si janë realizuar investimet janë shqetësim i madh.

Pasqyrimi i të dhënave në disa drejtori rreth shpenzimeve për projektet kapitale, si në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe në disa drejtori të tjera, konsideroi se janë të pa qarta. Marrë parasysh këtë gjendje, besoj se shumë më shqetësuese është realizimi i buxhetit në këtë formë, prandaj kërkoj përgjigje dhe të sqarohen këto dilema në këtë raport.

**Hafiz Krasniqi**, tha se ne jemi duke diskutuar për raportin tremujor e jo për një raport vjetor, kështu që raporti financiar i një tremujori i përshkruan të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur edhe të hyrat, edhe shpenzimet, edhe te shpenzimet tjera të cilat ndodhin

kohë pas kohe në periudhën kohore edhe për atë duhet të diskutojmë, pra kur kemi të bëjmë me raporte tre mujore kemi të bëjmë me shifrat të cilat janë të dedikuara konkret për tre mujorin.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtore, Alban Zogaj, nënkryetar, Krenar Xhaferi, drejtor dhe Adelina Sahiti, drejtore.

**U konstatua se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2023 (TM3).**

**Pika e tretë**

**Propozim vendimi për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve, lagjeve urbane me nr. 01.020/07-257562/22, të datës 25.11.2022**

**Jeta Rafuna - Hasani**, propozoi që në Komisionin për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, të bëhet zëvendësimi nga Bersant Beka në Vigan Kastrati i cili është drejtor i Drejtorisë së Administratës.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve, lagjeve urbane me nr. 01.020/07-257562/22, të datës 25.11.2022.**

**Pika e katërt**

**Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria histori në harta"**

Arsyeshmërinë për këtë propozimvendimi e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. **Nora Kelmendi**, ngriti sheqetësim rreth këtij propozimvendimi e cila tha se me rastin e ndarjes së mjeteve për subvencionim nuk janë respektuar fare kriteret të cilat i parasheh Rregullorja

MF 04 2017 e Ministrisë së Financave dhe Rregullorja për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, kështu që pothuajse në secilën mbledhje të Kuvendit po sillen pika të rendit të ditës të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi. Një shkelej të tillë gjejmë edhe në këtë propozimvendim, pra pas pesëdhjetë e dy ditëve ka ardhur në Kuvend, kështu që është shkelë afati prej tridhjetë dite.

**Gëzim Mehmeti** tha se në rast se afatet janë shkelur atëherë nuk besoj se cili asamblist me vetëdije bënë në këtë rast shkelje ligjore, kështu që konsideroi se votimi i saj është shkelje ligjore.

**Feim Osmani** ngriti sheqetësim rreth këtij propozimvendimi, si dhe për ndarjen e mjeteve për ndërmarrjet publike lokale, me ç'rast tha se para se të shpërblehen këto me

Faqe6nga16

subvencione të raportohet edhe njëherë për gjendjen e tyre këtu në Kuvend dhe të marrim informatë saktësisht se kah jemi duke shkuar me këto ndërmarrje, sepse janë bërë barrë e rëndë. Kërkoj që të jet një kujdes në shpenzimin e parasë publike.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtore dhe Përparim Rama, kryetar.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit "Shqipëria histori në harta".**

**Pika e pestë**

**Propozim -vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës.**

Lidhur me këtë propozim vendim, arsyeshmërinë për këtë e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

**Gëzim Sveçla**, tha se shumica e këtyre subvencioneve të propozuara janë propozime për të subvencionuar të afërt, familjar, bashkë partiak, bashkë punëtorë të një pjese të ekzekutivit këtu në Prishtinë, pra kjo është qeverisja e juaj që na e keni ofruar tash e dy vite dhe asnjëherë Prishtina nuk ka qenë ma keq në aspektin administrativ dhe ligjor. Keni krijuar precedent të rrezikshëm që, përveç që nuk po i respektoni vlerësimet ose opinjonet e organeve të cilat e përcjellin Komunën e Prishtinës, tani keni filluar edhe ti sfidoni vendimet e organeve gjyqësore, nuk po i respektoni po e sfidoni sistemin e drejtësisë, etj.

**Nora Kelmendi** tha se dokumentacioni për këtë propozimvendim është i mangët, mungon certifikata, pastaj ne nuk e dimë a është OJQ , a është kompani private, dhe pse të ndahen mjete për një konferencë që ka kaluar, konferenca ka qenë prej dt.12 - 15 tetor 2023.

**Gëzim Mehmeti** tha se më mirë do të kishte qenë që këto subvencione të ndahen aty ku ka nevojë, që ato mjete me i dedikuar diku tjetër, prandaj sipas mendimit tim këto subvencione janë sipërfaqësore që në realitet nuk kanë të bëjë me qytetin.

**Ajet Brajshori** tha se nuk na bënë nder e aq më pak kurë ka prezentë të tendencave apo të gjërave të njollosjes dhe gjërave që nuk janë etike për Kuvendin tonë dhe normalisht për nivelin çfarë e ka ky kuvend si kuvend i Kryeqytetit. Bisedimet e tilla në këtë mënyrë e ulin nivelin e këtij kuvendi deri në këtë masë, prandaj edhe një herë po bëj thirrje që diskutimet jo vetëm sot por edhe në të ardhmen ti japim ngjyrim këtij Kuvendi që të jemi shembull për kuvendet tjera.

**Leutrim Retkoceri** tha se është e frytshme për demokracinë dhe për secilën qeverisje edhe kritika e opozitës kur ka të gjetura praktike edhe kur ka të gjetura bindëse edhe para Kuvendit mi trajtuar, me i ndal ato nëse janë të tilla nëse nuk janë ju bëjë thirrje me i ushtruar të gjitha mekanizmat deri në fund, kështu që këto pika nuk përfundojnë me një votim në Kuvend, kanë me marrë edhe një opinion të ligjshmërisë nga MAPL -ja.

Lidhur me vërejtjet e dhëna nga parafolësit sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës.**

**Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për mbajtjen e Garës Kombëtare të Robotikës për vitin shkollor 2023/2024.**

Pë këtë pikë të rendit të ditës, arsyeshmërinë e paraqiti Valbona Makolli drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, u miratua Vendimi për për ndarjen e mjeteve financiare për mbajtjen e Garës Kombëtare të Robotikës për vitin shkollor 2023/2024.**

**Pika e shtatë**

**Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Children's new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina's Schools".**

Arsyeshmërinë për këtë propozim-vendim e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. **Valbona Ajeti** tha se ndarja e mjeteve në shumën prej 80 mijë euro për sigurimin e literaturës për bibliotekat qarkulluese dhe për trajnimin e mësimitdhënësve të gjuhës shqipe të klasëve 6 – 9 të shkollave fillore për fushën e lexim-kuptimit. Lidhur me këtë propozoi që ky trajnim të shtrihet edhe në shkollat e mesme. Marrë parasysh këtë, e mirëpres këtë trajnim, sepse na duhet edhe për licencim neve mësimitdhënësve. Po ashtu kërkoi të dijë se kur do të fillojë trajnimi dhe a do të ftohen mësimitdhënësit apo vetëm disa prej tyre.

Lidhur me çështjet e ngritura nga znj, Ajeti, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtore.

**Gëzim Mehmeti** ngriti shqetësim rreth subvencionimit të një kategorie të veçant, me çrast tha se, a jemi duke i shikuar këto rrethana ligjore, për një kategori të veçantë, ku kemi të drejtë ta ndajmë vetëm 5 % të buxhetit të paraparë, kështu që mendoj se mos po i tejkalojmë këto kategori.

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Children's new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina's Schools".**

**Pika e tetë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Gjithçka rreth IV"**

Arsyeshmërinë për këtë propozim-vendim e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.. **Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin "Gjithçka rreth IV".**

Faqe8nga16



### **Pika e nëntë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare "Vrapo Babadimër".**

Lidhur me këtë propozim vendim, arsyeshmërinë e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare "Vrapo Babadimër"

### **Pika e dhjetë**

**Propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizmin e konferencës "Growzillas L.L.C".**

Arsyeshmërinë për këtë pikë e paraqiti, Valbona Makolli, drejtore. Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Vendimi për vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizmin e konferencës "Growzillas L.L.C".

### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Pallati i Rinisë" SHA.**

Për këtë pikë arsyeshmërinë e paraqiti, Valbona Makolli, drejtore.

**Nora Kelmendi** tha se ndërmarrjet publike lokale e kanë pasur afatin që deri më 31 tetor të raportojnë dhe ne nuk kemi marrë asnjë raport nga ato. Kishte me qenë mirë që së pari të raportojnë pastaj me ju nda subvencione dhe mjete.

**Triera Kasumi-Berisha** tha se është shqetësuese që ne çdo vit financojmë ndërmarrje publike e të njëjtën kohë që nuk kemi raporim, nuk kemi as plane të bizneseve të ndërmarrjeve publike në bazë të cilave ne kishim mund me shiku nëse këto ndërmarrje kanë kapacitetin me prodhu të hyra dhe me mbajt veten dhe jo vetëm me përfund duke paguar paga të punëtorëve, pra ne vetëm po krijojmë shpenzime dhe asgjë tjetër.

**Feim Osmani** tha se është shqetësuese pse kjo ndermarje nuk ka pas një plan të biznesit në tre muajt e parë kur janë emëruar aksionarët ku ne ju kishim referuar në të ardhmen se ku ka problem, ku ka çalime. Nuk duhet t'i trajtojmë gjitha ndërmarrjet njësoj, p.sh., Pallati i Rinisë do duhej të ishte ndërmarrje fitimprurëse, nëse nuk gjeneron të ardhura për Prishtinën, së paku le t'i mbajë punëtorët e vet dhe aktivitetet e veta me të hyrat e veta, sepse aty ka objekte me qira, kështu që ajo është një ndërmarrje e cila gjeneron të hyra dhe ne nuk kemi një raport me e shikuar se çka ka ndodh.

**Gëzim Mehmeti** tha se për këtë ndermarrje nuk kemi një bilanc dhe nuk e dimë si është gjendja momentale. Unë i kuptoj ndërmarrje publike që kanë telashe financiare dhe sa i përket bilancit janë minus, por nëse një ndermarrje ka mjete në xhirollogari e nuk ka bilanc, me të vërtetë kjo është shaka sa i përket menaxhimit të parasë publike.

**Arianit Beqiri** tha se sa i përket subvencionimit të kësaj ndermarrje nuk ka logjikë për shkak se nuk ka raport dhe ne nuk kemi asnj plan të biznesit se çka kish me bër Pallati i Rinisë. Nëse ne do të votojmë për diçka që nuk e dimë, mendoj se është gabim.

**Fiknete Bejta** tha se Pallati i Rinisë ka racionalizuar shpenzime administrative të panevojshme, ka rritur të hyrat buxhetore, është ndërmarrje likuide dhe profitabile. Investimet në Pallat të Rinisë janë imediate dhe janë shumë të nevojshme dhe prej që kur është ndërtuar Pallati i Rinisë në vitin 1975 më nuk është renovuar. Platforma e Pallatit të Rinisë duhet urgjent me u renovu dhe kostoja minimale e këtij renovimi është 1.2 milion euro. Sa i përket raporteve financiare, ne e kemi dërguar në muajin qershor raportin për Pallatin e Rinisë, mirëpo rrethant që janë krijuar atëherë na kanë pamundësuar të raportojmë. Kësaj ndërmarrje nuk i mjaftojnë të hyrat që gjenron në vit nga qiratë, sepse më shumë është aset kulturor sportiv dhe duhet të kem këtë qasje ndaj Pallatit të Rinisë. **Petrir Reçica** propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që mungojnë raportet, kështu që ne jemi për ti përkrahur këto subvecione por në mungesë të raporteve nuk dijmë se çka po votojmë.

Lidhur me vëretjet dhe sugjerimete dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhan Alban Zogaj, nënkryetar, Përparim Rama, kryetar dhe Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Pallati i Rinisë" SHA.**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Sport Marketing".**

Arsyeshmërinë për këtë propozim-vendim e paraqiti Valbona Makolli, drejtore. **Elmira Nikqi- Rexha**, në cilësinë e anëtares së komisionit komunal të aksionarëve tha se ndërmarrja "Sport Marketing" sfidë kryesore e ka hapësirën dhe mundësinë e krijimit të të hyrave, sepse deri më tani ka funksionuar vetëm me një aset, siç është Pishina e Gërmisë, aset ky i amortizuar dhe në mungesë të investimeve dhe mirëmenaxhimit për shumë vite të kaluara. Vlen të theksohet se deri tani është duke u punuar në planin e zhvillimit dhe zgjerimit të ndërmarrjes, e cila do t'u ofrojë mundësi tjera për ta shtuar vlerën e veprimtarisë, të cilën duhet ta ushtrojmë në plotni. Kërkesa jonë për subvencion është e domosdoshme, sepse ndërmarrja jonë është në proces të transformimit dhe të riorganizimit dhe për këtë arsye është koha që të kërkojmë një ndihmë financiare sa i përket mbarëvajtjes së punës tutje. Nevojë e domosdoshme është investimi substancial në ndërmarrje, sepse potenciali dhe mundësia për të ofruar vlerë të shtuar të kryeqytetit në përgjithësi është e madhe.

**Triera Kasumi - Berisha** kërkoi nga ekzekutivi që të ndërmerren masa dhe të shikohen këto detaje financiare, të cilat i paraiti znj. Rexha. Po ashtu tha se kemi një kritikë rreth ngritjes së çmimeve për shërbimet në Pishinën e Gërmisë, etj.

**Feim Osmani** tha se në pa mundësi të zgjerimit të gamës së shërbimeve është krijuar një ndërmarrje e cila është bë barrë e Komunës së Prishtinës dhe ku është logjika që të vazhdohet edhe më tutje kështu, pse të vazhdohet tutje me një ndërmarrje e cila nuk ka as plan me zgjeru gamën e shërbimeve dhe do të jetë barrë e përhershme sipas kësaj logjike.

**Sami Boroci** tha se është e pamundur me operu një ndërmarrje kur ka vetëm një operator ekonomik sezonal, kështu që mendoj që duhet bërë shumë lëvizje konkrete në këtë drejtim. Nuk e kam problem me subvencionu ndërmarrje ku e prekun direkt jetën e njerëzve në qytet, por të subvencionohen pagat e punëtorëve për disa vite me radhë, atëherë ku është logjika me ekzistë kjo ndërmarrje.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shitesë dha Përparim Rama, kryetar.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Sport Marketing".**

**Pika e trembëdhjetë**

**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit "Ec me mua".**

Arsyeshmërinë për këtë propozimvendim e paraqiti Donika Çeta, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit "Ec me mua".**

**Pika e katërbëdhjetë.**

**Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugiocave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të tjera publike në Kryeqytet.**

Arsyeshmërinë për këtë propozimvendim e paraqiti Arbër Sadiku, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugiocave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të tjera publike në Kryeqytet.**

**Pika e pesëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Lakërishta", për bllokun "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8" në Prishtinë.**

Arsyeshmërinë për këtë propozimvendim e paraqiti Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Gëzim Sveçla**, kërkoi të dijë se cilat janë ato nevoja dhe kush i ka konstatu. Cila është ideja edhe në çka jeni bazuar që të bëhen këto revidime në at zonë kur e dimë se ajo zonë është tejet e ngarkuar me ato ndërtimet e larta.

**Gëzim Mehmeti** tha se është dashur me paraqitur rrugën që do të ndryshohet, me na dhënë më shumë arsye, sepse është në interes të publikut dhe qytetit të Prishtinës. Po dua të di a ka vetëm të bëjë me infrastrukturë apo çështjen e ngritjes së koeficientëve në atë zonë, nëse është çështja e ngritjes së koeficientëve është në kundërshtim me atë që ka deklaruar kryetari dhe është një gjë e cila nuk ka sens urbanistik.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhan Përparim Rama, kryetar dhe Arber Sadiki, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Lakërishta", për bllokun "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8" në Prishtinë.**

**Pika e gjashtëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023.**

Arsyeshmërinë për këtë pikë të rendit të ditës e paraqitën Alban Zogaj, nënkryetar dhe Fisnik Osmani, kryeshef ekzekutiv në NPL "Termokos".

**Gëzim Sveçla** tha se ne i kemi vërejtjet tona rreth subvencionimit të kësaj ndërmarrje publike lokale, për shkak se vlerësojmë se bëhet me të vetmin qëllim që të rritet përqindja e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023, e që kjo ndarje e mjeteve ka mund të planifikohet me rastin e votimit të buxhetit dhe jo tani në fund të vitit ku kushtet klimatike në vendin tonë nuk e lejojnë zhvillimin e projekteve në ambiente të jashtme ose të paktën zhvillimin e projekteve me dinamikë më të madhe. Dyshimet tona janë kryesisht në aspektin ligjor, për shkak se arsyeshmëria e ndarjes së mjeteve në këtë fazë nuk është bindëse dhe nuk qëndron, dhe fatkeqësisht mendojmë që e njëjta nuk do t'i kaloj filtrat ligjorë.

**Sami Boroci** tha se e përkrahim këtë propozimvendim dhe me të vërtetë mendoj se është diçka shumë e mirë që po ndodhë. Termokosi është njëra nga ndërmarrjet që është një storje suksesi dhe krenari e Prishtinës dhe është njëfarë identiteti i Prishtinës. Uroj që me pas një trend të rritjes dhe zhvillimit të mëtutjeshëm.

**Feim Osmani** ngriti sheqtësim rreth subvencionimit të kësaj ndërmarrje i cili tha se po bëhet një transfer nga kategoria e investimeve kapitale te një ndërmarrje e cila e ka një plan për dy vitet e ardhshme dhe e cila ka mundur të bëj kërkesë shumë më herët që të buxhetohet në buxhetin e rregullt të vitit 2024 ose me u paraparë në kornizën buxhetore që ka qenë për 5 vite. Qëllimi kryesor i tij është për të rregulluar tabelat financiare në fund të vitit. Konsideroi se brengë kryesore do të duhej të ishte se si menaxhohen këto mjete, çfarë bëhet me to dhe me shumë projekte të tjera e jo me tabela në fund të vitit, sa janë shpenzuar e sa nuk janë shpenzuar sepse paratë e taksave të qytetarëve duhet të menaxhohen, duhet të investohen e jo të shpenzohen.

**Triera Kasumi - Berisha** kërkoi të dijë se a ekziston ende që Termokosi mbivlerëson pasuritë e llogarive të argëtueshme për të zburuar pasqyrat financiare, apo për shkak të mungesës së kontroleve të brendshme që nuk dokumentojnë burimin e këtyre llogarive të argëtueshme, andaj kemi nevojë të dimë nëse kemi një rregullore për provizionimin e llogarive të argëtueshme që ta dimë çfarë ka ndodhur me këto mjete të cilat nuk e dimë se kush i ka borxh ndërmarrjes.

Lidhur me vërtjetet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhan Fisnik Osmani, kryeshef, Përparim Rama, kryetar dhe Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023.**

**Pika e shtatëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ-së "Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës".**

Arsyeshmërinë për këtë pikë të rendit të diës e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

**Jeta Rafuna** tha se ky projekt ka për qëllim prezantimin dhe aftësimin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta si dhe të gjithë mësimdhënësve të fushës përkatëse me teknologjinë më të fundit të teknologjisë 3D, gjegjësisht 3D printimit.

**Gëzim Sveçla** kërkoi të dijë se cila është ekspertiza profesionale e organizatës e cila e ofron këtë trajnim, kush janë personat të cilët do ta bëjnë këtë trajnim, ku i kanë përfunduar kurset apo çështjet e tjera që kanë të bëjnë me aspektin e tyre profesional, pasi që ka dyshime rreth profesionalizmit të pronares së kësaj organizate e cila e bënë trajnimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e OJQ-së "Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës.**

**Pika e tetëmbëdhjetë**

**Pyetje dhe Përgjigje.**

**Faton Zeka, për Kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publik**

- Eshtë kërkesë e një numri të pronarëve të bizneseve private që operojnë në Prishtinë, që të dielën me e bërë ditë pushimi, të jet obligative për shumicën e bizneseve private në Prishtinë.

Lidhur me kërkesën e shtruar, përgjigje dha Përparim Rama, kryetar.

**Gëzim Sveçla, për nënkryetaren e Komunës, kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.**

- Edhe përkundër një vendimi të dhënë nga gjykata për mbylljen e rrugës "Rexhep Luci", ajo rrugë përkundër këtij vendimi vazhdon të jetë e mbyllur, ndërkohë që masa ka pasur qëllimin që mos të mbyllet deri në trajtimin meritator të çështjes,
- Disa vendime po merren pastaj i keni pezulluar dhe po detyroheni ti ndryshoni, rasti i fundit është me furnitorët,
- Rasti me trotinetët, nga viti i kaluar, keni marrë një vendim që trotinetët të mos kalojnë nëpër sheshin "Nëna Terezë", tërë verën trotinetët kanë shëtitur aty, si po e trajtoni këtë çështje,

- A mund ta kam një përgjigje për pyetjen e bërë në seancën e kaluar në lidhje me një pronë të cilën e keni këmbyer, çështja e pronave me qira marrje të garantuar,
- Çështja e deratizimit, në lagjen "Emshir", është kërkesë e banorëve të kësaj lagje që të ndërmerren masa në eliminim e minjëve,
- Çështja e dytë ka të bëjë me një mesazh në rrjetin "Viber" i cili ka qarkulluar tek punëtorët shëndetësor të Komunës së Prishtinës, ku janë të obliguar të marrin pjesë në një ngjarje tuajën për shkak se po citoj: "Është kërkesë e drejtorit",
- Kryetar, në një emision televiziv ndër të tjera keni deklaruar që një pjesë të obligimeve që i keni ndaj bankave i paguani nga të hyrat të cilat i siguroni nga qiratë në ndërtesat të cilat i keni në pronësi në Londër,
- Pyetje tjetër ka të bëjë me një çështje shumë të diskutuar kohëve të fundit që ka të bëjë me Festivalin e këngës në RTK. A mund ta di sa ka qenë përkrahja financiare e Komunës së Prishtinës për këtë ngjarje.

Lidhur me pyetjet e shtruara nga z. Sveçla, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Izet Sadiku, drejtor.

**Triera Kasumi- Berisha, për kryetarin e Komunës, për nënkryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Pse nuk është krijuar një linjë për rrugën "Rrustem Statovci", dmth prej prej rrugës "Agim Ramadani" deri lartë sepse është një zonë shumë e madhe e cila nuk mbulohet në asnjërin anë me "Trafikun Urban", është komplet Velania dhe Parku i Qytetit,
- Kur do ta kemi Rregulloren e "Prishtina Parking" dhe Rregulloren e parqeve,
- Deri ku ka mbërri procesi i matësve të ndotjes akustike me qenë se kam marrë shumë ankesa që këta detektorë, d.m.th pajisjet po detektojnë zhurma edhe të trafikut dhe pse disa lokale nuk kanë aplikuar fare për pajisje, çfarë ndodhë me këtë pjesë, si do të menaxhohet ky problem,
- Disa nga asetet e ish- Rilindjes, ( makina të printimit) që i ka bler Komuna e Prishtinës, kërkojmë që për ato asetet të kujdeset dikush, pasi që ato qenkan në gjendje tejet të keqe dhe janë jashtë objektivit,
- Pse, z. Krenar Xhaferi dhe z. Alban Zogaj nuk erdhët në emisionin kallxo. com për të folur më detalisht për rrugën "A".

Lidhur me pyetjet e shtruara nga znj. Kasumi-Berisha, përgjigje dhan Përparim Rama, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

**Feim Osmani, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Pse nuk u zgjat një linjë deri në Tenezhdoll, aty ku është fundi i kufirit të Prishtinës. Po të zgjatej kjo linjë, do të operonte me fitim së paku për 10 herë brenda ditës, ku do ta mbulonte edhe Bardhoshin, pastaj vazhdon deri në Tenezhdoll, vjen në Vranidoll, Besi, Lebanë, Trudë, prap në Bardhoshin dhe vjen në Prishtinë,

- Pengesat e vendosura në rrugën për në Besi, në fakt veq sa e vështersojnë qarkullimin, kërkojmë që ato pengesa të eliminohen pasi që kemi konstatuar se vendosj e tyre është e pa nevojshme,
- A do të vendoset tabela që tregon projektin e rrjetit të kanalizimit në Rimanishtë, dhe se a do të trajtohet një segment prej 200-250 m ku aty përfshihet edhe shtëpia ime,
- Është kërkesë e banorëve të fshatit Besi që t'iu zgjatet orari i punës së barnatoreve edhe pas orës 21.

Për pyetjet dhe kërkesat e shtruar nga z. Osmani, përgjigje dhanë Krenar Xhaferi, drejtor dhe Ilirik Musliu, drejtor.

### **Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të Kontratave dhe për kryetarin e Komunës**

- Banorët afër rrugës "Ukë Sadiku" në lagjen "Taslixhe", kërkojnë të dinë se kur do të përfundoi ndërtimi i kësaj rruge, pasi që ata dëshirojnë të krijohet një infrastrukturë, si kanalizim, ujësjellës dhe ndriçim,
- Kur do të filloi shtrirja e rrjetit të Termokosit në lagjen "Kodra e Trimave".

Për pyetjen e parashtruar nga z. Krasniqi, përgjigje dha Krenar Xhaferi, drejtor.

### **Pika e nëntëmbëdhjetë Të ndryshme**

**Faton Zeka** tha se lagja "Emshir" është njëra ndër lagjet më së afërti me Kryeqytetin dhe nuk është trajtuar fare nga qeverisjet e Prishtinës, do të ishte mirë që në këtë lagje të intervenohet në rregullimin në përgjithësi të infrastrukturës.

Për çështjet e ngritura nga z. Zeka, sqarime dha Përparim Rama, kryetar.

**Gëzim Sveçla**, me diskutimin e tij kryesisht u fokusua në projektin e rrugës A "Xhim Xhema", duke shprehur paknaqësi me gjuhën e përdorur nga Kryetari i Prishtinës në një reagim të tij publik që me të vërtetë nuk i bën nder pozitës të të parit të Prishtinës që të përzihet në çështje të sistemit të drejtësisë. Lidhur me këtë ceku se për shkak të një padie të cilën e ka bërë një kompani private e cila ka marrë pjesë në këtë garë, e që në fakt padinë nuk e ka bërë as Lëvizja Vetëvendosje, as nuk e ka bërë Qeveria, as nuk e ka bërë ndonjë asamblist këtu, kështu që në një garë për të fituar një kontratë, një operator ekonomik pretendon që i është bërë e pa drejtë, ka rastisur që ky operator ekonomik të jetë i afërt me subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës. Ne nuk jemi ngritur të themi që LDK-ja po e bllokoi rr. "A", kështu që impakti ose ndikimi i Lëvizjes Vetëvendosje në këtë çështje ka qenë zero.

Mendoj që kjo duhet të marrë fund për shkak se z. kryetar Prishtina tashmë ka një historik të pasur të shkeljeve ligjore nën qeverisjen tuaj, me apo pa vetëdijen tuaj, me apo pa qëllimin tuaj. Praktika e ka dëshmuar që shumë vendime të cilat janë marrë, janë kontestuar

nga organet të cilat e mbikëqyrin këtë punë, e që qasja e juaj ka filluar të shkaktojë irritim edhe te qytetarët, edhe të ne këtu si përfaqësues të asamblesë.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Sveçla, sqarime dhan Përparim Rama, kryetar dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

**Gëzim Mehmeti** tha se problemin e zgjidhjes së kaosit në komunikacion e zgjidh vetëm unaza, dhe se çdo lëvizje tjetër do të jetë e mirëseardhur. Konsideroi se është shqetësuese të dilet e të thuhet që një subjekt politik po e bllokoi rrugën pa argumente dhe për mua është shqetësuese të akuzohet një parti, sepse po dalin fakte që ankimi ka ardhur nga partia në pushtet në Komunën e Prishtinës.

Nuk e di dhe asnjëherë nuk dua të interferohem në çështje të gjyqësorit, por nëse kjo është fakt që një kompani e afërt me një subjekt politik dhe fajësohet subjekti tjetër, kjo nuk qëndron.

**Triera Kasumi - Berisha** kërkoi të dij se a do të vazhdojnë punimet në rrugën "A" dhe pse është shkarkuar z. Nexhmi Mekolli dhe është zëvendësuar me Valon Shehu, si zyrtarë i prokurimit. Për këtë kërkoi përgjigje nga kryetari, si dhe kërkoi të dij pse keni refuzuar përballjen në emision televiziv.

Mendoj që është shumë jo etike prap me na vu në pozitën që ne nuk dëshirojmë të përfundohet rruga "A".

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

*Mbledhja përfundoi në orën 18:30.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi



Faqe 16 nga 16